



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 54

Prishtinë, më 14. 04. 2010, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Integritet Evropian

Në mbledhje morën pjesë: Zylfije Hundozi, Džezair Murati, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani dhe Petar Miletij.

Mungoi: Naser Rugova.

Me ftesë: Besim Beqaj - ministër për Integritet Evropian.

Nga stafi i mbështetjes së Komisionit: Ahtere Loxha dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Blerim Vela, Marie Berishaj - përfaqësues të OSBE-së, Isuf Zejna - KDI, Besart Mustafa – praktikant dhe Mimoza Gojani - Ambasada Britanike.

Mbledhjen e kryesoi Zylfije Hundozi - kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të datës 29. 03. 2010,
3. Prezantimi i Besim Beqajt - ministër në Ministrinë për Integritet Evropian,
4. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 29. 03. 2010

Kryesuesja konstatoi se procesverbali i datës 29. 03. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Prezantimi i Besim Beqajt - ministër në Ministrinë për Integritet Evropian

Kryesuesja - E falënderoi ministrin për gatishmërinë për të bashkëpunuar me Komisionin për Integritet, si dhe e uroi për postin e ri. E njoftoi ministrin se Komisioni për Integritet Evropian pas publikimit të Raportit të Progresit e ka hartuar Planin e Veprimit, në të cilin i ka identifikuar sfidat konkrete për secilin ministri. E kemi mbikëqyrur edhe përmbushjen e Planit për Partneritet Evropian. Tjetër detyrë jona është edhe mbikëqyrja e projekteve të IPA-s. Deri më tani ka qenë zëvendëskryeministri, i cili çdo tre muaj ka raportuar para Komisionit, mirëpo asnjëherë deri më tani nuk kemi pasur raport të shkruar nga ai. Shpresoj se nga ju do të kemi edhe raporte më shkrim. A keni program pune apo do ta vazhdoni punën e Agjencisë për Koordinim dhe Zhvillim të Integritetit Evropian? Stafi, i cili ka qenë në Agjenci, a do të përfshihet tani në Ministrinë tuaj? A keni ndonjë plan për përkthimin e *acquis communautaire*? Siç e dimë, pas disa vizitave në Shqipëri, Ministria ka në plan që së bashku me Kosovën dhe me Maqedoninë ta fillojnë përkthimin e legjislacionit. A keni ndonjë plan lidhur me këtë nismë? Eksperti, i cili është duke e mbështetur Komisionin tonë, i ka dhënë disa propozime që në deklaratën e përputhshmërisë të përfshihen edhe tabelat e transpozimit të legjislacionit. A do të filloni me zbatimin e këtyre tabelave, sepse do të jenë shumë funksionale për secilin institucion?

Ministri Besim Beqaj - Ministria për Integritet Evropian është e re, e themeluar me vendim të Kryeministrit. Me themelimin e saj është shuar Agjencia për Koordinim dhe Zhvillim të Integritetit Evropian, dhe kjo Agjenci është shkrire në ministri. Agjencia kishte 35 zyrtarë. Cilësia e tyre është e nivelit shumë të lartë, andaj janë përfshirë të gjithë në Ministri. Shtoi se janë duke i përcaktuar detyrat dhe shumë shpejt do ta paraqesin për miratim fushëveprimin e Ministrisë në Këshillin e Ministrave. Sa i përket Ministrisë së Integritetit do të jemi bashkëbisedues të procesit politik dhe teknik ndërmjet Brukselit dhe Prishtinës. Linja jonë e bashkëpunimit do të jetë me të gjitha ministrinë dhe me Kuvendin, në veçanti me Komisionin për Integritet Evropian. Që nga dita e emërimit tim ministër, deri më tani, kam provuar ta njoh në thelb Agjencinë. Prioritete të Ministrisë do të jenë tri çështje. E para, të provojmë ta përmirësojmë Raportin e Progresit. Ky është një aktivitet, i cili vjen te ne, por bartet në të gjitha ministrinë e linjës, sepse është çështje me interes. Shumica e inputeve do të merren deri me 1 qershor, andaj do të ketë shumë punë për t'u bërë në këtë drejtim. E dyta, është procesi i përafrimit të raporteve tregtare të Kosovës me BE-në. E dini se e kemi marrë pyetësin e parë, i cili do të dorëzohet nesër në Komisionin Evropian. Njoftoi se në këtë proces kanë qenë të përfshira të gjitha ministrinë dhe se kanë pasur takime me OJQ-të, të cilat kanë pasur përvojë në këtë lëmi. Prioriteti i tretë është parapërgatitja për procesin e liberalizimit të vizave. Sa i përket procesit të liberalizimit të vizave nuk duhet të presim shumë, sepse është një proces relativisht i komplikuar, i cili kërkon shumë përgatitje legjislative dhe teknike. Ministria e Integritetit në këtë proces do të jetë përgjegjëse për hartimin dhe për zbatimin e politikave të Qeverisë për integritet evropian. Në këtë pikë themelore do të komunikojë drejtpërdrejt me BE-në. Sa i përket bashkëpunimit me Komisionin nuk do të kemi problem, sepse jam i gatshëm të paraqes raporte para Komisionit, edhe me shkrim. Njoftoi se gjatë këtyre ditëve është takuar me ambasadorët e vendeve të BE-së dhe me shefat e zyrave të BE-së. Si Ministri e re kemi nevojë për ngritje. E kemi përgatitur draftbuxhetin, në të cilin është paraparë shtimi i stafit. Sa i përket përkthimit të legjislacionit, është bërë një punë më parë, ndërsa tani vetëm do ta vazhdojmë. Procesin e integritetit është i ndjeshëm, e kërkon përkrahjen e të gjitha institucioneve dhe është koordinim teknik dhe politik. Lidhur me koordinimin teknik ju siguroj se stafi, të cilin e kam gjetur dhe i cili do të krijohet, nuk do të ketë asnjë problem, sepse është profesional. Për të do të investojmë edhe më shumë. Sa i përket koordinimit politik, ne vetëm, si Ministri, nuk mund të bëjmë asgjë, sepse kërkohet bashkëpunim i thellë ndërmjet institucioneve. Jemi të interesuar që në prioritetin, të cilin e ka caktuar Qeveria, integriteti në institucionet euroatlantike, të kontribuojmë me aktivitetin tonë të realizohet. Duhet të kemi shumë kujdes në vijimësinë e komunikimit, sepse nganjëherë ka shkuar te procesi i komunikimit. Nuk dëshiroj të kemi hendeqe për shkak të mosbashkëpunimit.

Kryesuesja - A keni planifikuar buxhet për zbatimin e Planit për Partneritet Evropian, sepse gjatë shqyrtimit të buxhetit kam vërejtur se nuk është paraparë mbulesë buxhetore për procesin e integrimeve evropiane? Është shumë e rëndësishme të kemi mbështetje të nivelit politik në këtë proces. Siç jeni në dijeni, është hartuar një plan për vitet 2008 – 2011. Shumë strukturave politike u janë ndarë detyra që të përshpejtohet procesi i integritit, duke filluar nga Këshilli Nacional, i cili përbëhet nga Presidenti, Kryeministri, zëvendëskryeministri e Kryekuvendari, por ky Këshill nuk është takuar kurrë. Sa i përket Këshillit Ndërmnistror, kam marrë pjesë në takimet e tij, mirëpo nuk kishte debate përmbajtësore. Në këto takime Qeveria po diskuton vetëm për të gjeturat e Raportit të Progresit. Çka do të bëhet me këto struktura? A do të jetë zëvendëskryeministri personi politik, i cili do ta përkrahë edhe më tutje procesin?

Fatmir Rexhepi – E vlerësoi rëndësinë e madhe që e ka themelimi i kësaj Ministrie. E përgëzoi ministrin, për të cilin tha se është ndër kuadrat me performancë më të mirë politike dhe me përvojën, jo vetëm në Odën Ekonomike, por edhe në kuadër të koordinimit të Paktit të Stabilitetit. Shtoi se ai ka edhe shumë përvoja të tjera. Kjo flet se kemi nevojë që me kuadro të tilla të bashkëpunojmë për aktivitetet tona shtetërore. Mendoj se kapaciteti intelektual i ministrit dhe përvoja, që i përmenda më parë, do të reflektojnë, jo vetëm në paraqitjen, por edhe në punën shumë të suksesshme të tij. Kërkoj që Komisioni Parlamentar dhe Kuvendi t'i japin përkrahje të plotë kësaj Ministrie në përmbushjen e kritereve kryesore, por edhe të atyre, që do të dalin, të cilat janë me qindra dhe për të cilat do të ketë bashkëpunim shumë të shpejtë e shumë të mirë.

Unë u jap përkrahje të plotë këtyre aktiviteteve të kësaj Ministrie, sepse na mbetet punë e madhe për t'i përmbushur vërejtjet, që kanë të bëjnë me Raportin e Progresit, që aspak nuk janë të lehta. Kemi të bëjmë me ndërtimin dhe me forcimin e demokracisë, me shtetin ligjor, me korrupsionin, me krimin e organizuar dhe me shumë gjëra të tjera, që kanë notë negative. Mendoj se do të jenë sfida, me të cilat duhet të përballemi për t'i përmbushur, që ta ndryshojmë ecurinë me një zhvillim sa më të shpejtë ekonomik e shoqëror. Qoftë ne, qoftë Kuvendi, qoftë Qeveria, duhet t'i avancojmë punën dhe nivelin tonë, për reformat të cilat i duhen secilës, në hap me nevojat dhe në hap me kohën. Nëse këtë mund ta arrijmë bashkërisht, mendoj se të gjitha institucionet do të ecin përpara.

Njomza Emiri – E njoftoi ministrin se Komisioni ka pasur shumë aktivitete për përmbushjen e sfidave, të cilat kanë dalë nga Raporti i Progresit. Shpresoj se kjo Ministri do të angazhojë kuadër profesional, që do të jetë i aftë t'i përmbushë detyrat. Çka keni paraparë në draftbuxhetin e Ministrisë dhe si e keni planifikuar organizimin e kësaj Ministrie?

Dzezair Murati – E pyeti ministrin për punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve në këtë Ministri. Me formimin e kësaj Ministrie, shteti ynë do të bëjë përpjekje që ma lehtë të integrohemi në BE. Sa u përket shteteve arabe, kur bëhet fjalë për çështje materiale, sugjeroj që në këto vende, duhet të dihet kë e kërkon për ta takuar. Deri më tani nuk mund të krenohemi me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Komisioni ynë, si i ri, ka nevojë t'i vizitojë shtetet e tjera për të marrë përvojë. Deri më tani i kemi vizituar shumë pak shtete. Me rastin e vizitës në Kroaci kemi arritur të marrim përvojë shumë të mirë. Për këtë qëllim do të na shërbenin edhe përvojat e shteteve të tjera. E falënderoj ministrin me bindje se do të jetë dera e hapur për bashkëpunim me anëtarët e këtij Komisioni.

Nait Hasani – E përshëndeti ministrin për gatishmërinë e tij për bashkëpunim. Mendoj se na takon ta kemi një program të përbashkët të Komisionit dhe të Ministrisë që të ecet përpara. Deri më tani kemi pasur takime me zëvendëskryeministrin e caktuar për integrime evropiane. Njoftoi se kanë diskutuar për Raportin e Progresit që dy vjet, sepse kjo çështje ka qenë kompetencë e këtij Komisioni. Një gjë e tillë do të ndodhë edhe këtë vit, pas publikimit të Raportit, në muajin nëntor, nga Komisioni Evropian. Tani e tutje kjo barrë do të bije edhe mbi ministrin tuaj. Komisioni e ka bërë një plan, i cili ka kaluar në Kuvend, por tani ai duhet të bëhet pjesë edhe e Ministrisë, që të shohim cilat veprime dhe në cilin afat mund të realizohen. Procesi i integritit nuk është proces vetëm i një mandati, vetëm i pozitës ose i opozitës, por është i krejt Kosovës. Niveli i bashkëpunimit të institucioneve tona duhet të jetë i ndërsjellë.

Kryesuesja - A i keni bërë prioritetet legjislativ për këtë vit? Po pyesim dhe po sugjerojmë me qëllim që bashkëpunimi të jetë në nivel.

Ministri Besim Beqaj - Falënderoj për përkrahjen dhe për sugjerimet e deputetëve. Për buxhetin e kemi përgatitur një draft, për të cilin jemi bazuar në ministrinë e tjera. Duhet të kemi kujdes që prioritetet e ministrive të tjera të jenë në përputhje me Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian, që prioritetet, të cilat janë përcaktuar, të mos pësojnë për shkak të buxhetit. Sa u përket strukturave politike të mëparshme për integritet, Ministria e Integritetit do të jetë pikë koordinuese e nivelit politik me ministrinë e linjës dhe me Kryeministrin në rrafshin horizontal dhe në rrafshin vertikal me zëvendëskryeministrat. Prioritetet legjislativ janë identifikuar në kuadër të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian. Plani është rishikuar dhe besoj se shpejti do të kalojë në Qeveri. Njoftoi se organizimin i Ministrisë do të jetë i njëjtë, siç ka qenë Agjencia, pra pjesa profesionale do të mbetet e njëjtë, vetëm se i është shtuar komponenti politik. Dëshirojmë të kemi më shumë organizim horizontal, sesa vertikal, sepse nuk dëshirojmë të kemi shumë burokraci. Sa i përket punësimit të minoriteteve, do të orientojemi në punësimin e studentëve, të cilët fitojnë bursat nga Agjencia dhe nga Komisioni Evropian. Njohjet nuk janë në kompetencat tona, sepse ne merremi posaçërisht me përafrimin dhe me koordinimin e aktiviteteve të bashkëpunimit me BE-në. Një pjesë e lotimit, ndoshta mund të bëhet në baza joformale, por nuk është prioritet yni.

Lidhur me hapjen e Ministrisë për bashkëpunim nuk dëshiroj të ndërhyj në agjendën tuaj, sa u përket udhëtimeve. Do të mundohemi të kemi më shumë bashkëpunim me ju. Duhet të angazhohemi që më shumë të na vijnë delegacione për vizitë në Kosovë, sesa të shkojmë ne te to, sepse bota ka nevojë ta njohë realitetin në vend. Ne do të organizojmë edhe udhëtime të përbashkëta, aty ku konsiderohet e nevojshme. E kam parë një plan operativ, i cili korrespondon me aktivitetet që dalin nga Raporti i Progresit. Edhe më tutje nuk e kemi të qartë rolin e institucioneve të linjës nëpër ministri, që kanë të bëjnë me integritetin.

Kryesuesja - A nuk do ta pasivizojë marrëveshja e përkohshme tregtare ekonominë tonë? Realisht për të mbërritur në tregun e BE-së duhet të krijojmë ekonomi reale të tregut, e cila do të jetë konkurrense me tregun e BE-së.

Ministri Besim Beqaj - Duhet ta kuptojmë se Kosova për pesë vjetët e ardhshëm ka raport preferencial tregtar me BE-në. Kjo do të thotë se çdo produkt që vjen nga Evropa do të doganohet, kurse çdo produkt që shkon nga Kosova në BE do të jetë i liruar nga doganimi, sipas një parimi të asimetrisë tregtare. Pyetësi është vetëm hap i parë, por nuk duhet të krijojmë iluzione, sepse ky është proces i gjatë. Ka pro dhe kontra në këtë proces, sepse duhet t'i krijojmë disa mekanizma funksionalë për ta ndihmuar ekonominë. Nëse pyetni, pse na i kanë dhënë raportet preferenciale, kjo u bë për shkak se këto raporte u jepën vendeve që kanë zhvillim të vogël ekonomik.

Për ne është mirë që ka filluar si proces, por na duhet shumë punë. Roli juaj, për ta krijuar strukturën ligjore, është i rëndësishëm.

Kryesuesja - E falënderoj ministrin për paraqitjen dhe kërkoj që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

4. Të ndryshme

a) Angazhimi i ekspertit për organizimin e dëgjimit publik

Kryesuesja - Ta angazhojmë një ekspert me mjetet e ndara nga buxheti i Kuvendit për Komisionin tonë, që të na ndihmojë në organizimin e dëgjimit publik. Dëgjimi publik, për sfidat e dala nga Raporti i Progresit për këtë Ministri, do të organizohet me Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës, pas dy javësh.

Kryesuesja konstatoi se pas diskutimeve të deputetëve u nxor ky

Përfundim

Të angazhohet eksperti, nga mjetet e ndara për Komisionin për Integritet, për organizimin e dëgjimit publik.

Mbledhja përfundoi në orën 15: 20 min.

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së komisioneve

Kryetare e Komisionit

Zylfije Hundozi